

**Flete udhezimi
per formularin mbi sqarimin
e marredhenieve personale dhe ekonomike
per shpenzimet procesuale**

- Ju lutem ruajeni kete flete udhezimi dhe kopjen e formularit te plotesuar ne dokumentat tuaja -

Udhezime te pergjithshme

Per cfare qellimi duhet ndihma e shpenzimeve procesuale?

Nese doni te beni nje denoncim ose nje kerkese ne gjykate, zakonisht duhet te paguani koston e gjyqit. Nese ligji pershkruan nje asistence nga avokati ose per arsye te tjera eshte e nevojshme asistence e avokatit, per kete ka te tjera kosto. Te tilla kosto i keni edhe kur doni te mbroheni ne nje proces gjyqesor.

Ndihma e shpenzimeve procesuale duhet t'ju mundesoj ndjekjen ose mbrojtjen e te drejtave tuaja nese ju keto kosto nuk mundeni ose mundeni pjeserisht ti mbuloni. Ajo mund te miratohet edhe nese per zbatimin e nje pretendimi duhet te ushtroni aktin ekzekutiv.

Kush ka te drejte te marr ndihme per shpenzimet procesuale?

Ligji per shpenzimet procesuale shkruan:

“Pala, e cila ne baze te marredhenieve personale apo ekonomike nuk arrin te mbuloje koston e procesit gjyqesor, ose mund ta mbuloje vetem pjeserisht apo mund te paguaje vetem me keste, ka te drejte te kerkoje ndihme per shpenzimet procesuale ne qofte se e drejta e pretenduar duket mjaft e arritshme dhe nuk duket e papergjegjshme.

Papergjeshmeria eshte ndjekja apo mbrojtja e te drejtes ku njera pale e cila nuk pretendon ndihme te shpenzimeve procesuale, ne vleresimin e arsyeshem te te gjitha rrethanave nga mbrojtja e se drejtes lihet menjane edhe pse ka perspektive te mjaftueshme suksesi”.

Kjo vlen edhe per shpenzimet procesuale. Ju keni te drejte te beni kerkese nese

- duhet te ndiqni nje proces, per te cilat shpenzimet e nevojshme nuk mund te mbulohen ose te mbulohen pjeserisht **dhe**
- sipas vleresimit te gjykates ka pritshmeri jo te uleta suksesi **dhe**
- nuk do te hiqnit dore nga procesi gjyqesor, nese do ti merrnit vete persiper shpenzimet.

Nuk keni te drejte per shpenzimet procesuale nese **siguracioni i mbrojtjes juridike** ose **nje tjeter institucion** do te merrte persiper shpenzimet tuaja. Ajo nuk do te jepet edhe per shkak te nje detyrimi te mirembajtjes ligjore dikush tjeter do ti merrte shpenzimet persiper. Mund te jene bashkeshorti ose partneri i regjistruar ose bashkeshortja ose partnerja e regjistruar, kurse te nje femije i pamartuar mund te jene prindrit ose njera pale prinderore.

Cfare jane shpenzimet procesuale?

Shpenzimi procesual eshte nje sherbim asistence ne fushen e administrates se drejtesise. Nese merrni shpenzime procesuale duhet qe per koston e gjyqit dhe koston e veta te asistences legale sipas marredhenieve personale dhe ekonomike te mos kryeni pagesa ose vetem pagesa te pjesshme. Nga te ardhurat tuaja duhet te paguani posacerisht maksimalisht deri ne 48 muaj

keste. Shuma e ketij kesti eshte e percaktuar nga ligji.

Kostot e asistences suaj nga avokati do te merren persiper, nese gjyqi ju akordon nje avokat, avokate ose nje person te afte koordinues. Vecanerisht per kete duhet bere kerkese. Avokati ose avokatja ne parim duhet te jete i vendosur ne gjykatën kompetente te zones. Per ndryshe gjykata mund ta realizoje kerkesen koordinuese vetem, nese nuk ka shpenzime te metejshme.

Nese marrdheniet tuaja personale dhe ekonomike permiresohen mjaftueshem, mund te paguani edhe me vone mbas 4 vjetesh qe prej vendimit perfundimtar ose perfundimi te procesit pagesa shtese. Nese marrdheniet tuaja ekonomike perkeqesohen eshte e mundur nje ulje e kesteve te percaktuara me pare.

E rendesishme:

Gjate procesit gjyqesor dhe nje periudhe kohore prej 4 vitesh qe prej vendimit te formes se prere ose nje perfundimi tjetër te procesit jeni te detyruar qe ti jepni gjyqit cdo lloj permiresimi te gjendjes suaj ekonomike ose ndryshimin e baneses suaj ne menyre te menjehershme pa jua kerkuar gjykata. Te ardhurat e tanishme duhet te raportohet per cdo permiresim qofte edhe te vetem prej me shume se 100 € ne muaj. Ne qofte se ka reduktime te kostove te baneses, mirembajtjes, detyrimet e pagesave ose te ngarkesave te vecanta ose nese keto hiqen te gjitha duhet te raportoni edhe per kete vullnetarisht, nese shkarkesa i kapercen jo vetem nje here 100 € ne muaj. Nje permiresim thelbesor i marredhenieve ekonomike mund te vij edhe permes fitimit te mbrojtjes se te drejtes. Edhe kete permiresim duhet t'ia raportni gjykates. Ne qofte se i shkelni keto detyrime atehere mund te anulohet ndihma e shpenzimeve procesuale dhe duhet te paguani me vone shpenzimet.

Cilat rreziqe duhen vene re?

Nese duhet te ndiqni nje proces gjyqesor duhet te informoheni saktesisht, se sa eshte kostoja e gjyqit **dhe** e avokatit perkatesisht. Kjo vlen edhe per shpenzimet procesuale. **Kjo nuk perjashton cdo rrezik kostoje.**

Ne vecanti nuk behet fjale per shpenzimet qe pala e kundert perdor p.sh. per asistencen legale. **Nese e humbisni procesin gjyqesor do t'ju duhet te paguani palen e kundert ne rast se miratohet ndihma per shpenzimet procesuale.** Nje perjashtim eshte ne gjykatën e punes :Ketu **ne shkallen e pare** nuk duhet te rimbursoni kostot e pales kundertshtare edhe nese humbisni. Per nje asistencë avokatie ne proces ne lidhje mbi ndihmen e shpenzimeve procesuale, ka kosto. Keto kosto duhet ti pershtasni nese nuk korrespondojne me kerkesen tuaj. E njejta gje vlen per kostot e gjykates tashme te shkaktuara dhe per ato qe do te rezultojne akoma.

Kete duhet ta pershtasni nese nuk i korrespondohet kerkeses suaj. E njejta gje vlen per shpenzimet gjyqesore qe tashme kane lindur dhe per ato qe do lindin.

Si merren ndihmat e shpenzimeve procesuale?

E domosdoshme eshte qe te behet **kerkesa**. Ne kerkese duhet te paraqisni ne menyre te detajuar dhe te plote marrdhenien e zenkes. Ne kerkesen drejtuar gjykates e percaktuar nga ligji duhet dhene ne menyre perfundimtare "persektive te mjaftueshme per sukses" (shiko me lart). Duhet te jepen **provat**. Per keto pyetje nese eshte e nevojshme duhet te keshilloheni nga nje avokat. Gjithashtu duhet te informoheni edhe ne lidhje me **ligjin e ndihmes se keshillimit**, sipas se cilit personat me te ardhura dhe trashegimi te uleta mund te bejne kerkese per nje asistencë keshillmore pa leke ose me ulje thelbesore.

Kerkeses duhet ti bashkangjisni dhe nje **sqarim ne lidhje me marredheniet personale dhe ekonomike** (marredheniet familjare, profesionin, trashegimine, te ardhurat) se bashku me

dokumentat perkatese ne kopje. **Per kete sqarim duhet te perdorni formularin e pranishem.** Ndihma per shpenzimet procesuale mund te jepet si parim vetem mbas berjes se plote te kerkeses, sqarimit si dhe te gjitha provave te nevojshme. Formulari duhet te plotesohet perkatesisht prej secilit prej kerkuesve apo kerkueseve. Te minorenet, marredheniet personale dhe ekonomike te tyre si dhe te personave qe jane pergjegjes per mirembajtjen e tyre duhen plotesuar te kopjet e tjera te formularit.

Gjykata vendos nese juve do tu jepet ndihme per shpenzimet procesuale apo jo. Duke qene se fondet per ndihmen e shpenzimeve procesuale mbulohen nga taksat e komunitetit (taksa paguesit), duhet shqyrtuar nese jeni pretendues per te marr ndihmen e shpenzimeve procesuale. Formulari duhet te lehtesoje shqyrtimin. Per kete gje duhet te keni mirekuptim, qe duhet te paraqisni marredheniet personale dhe ekonomike.

Lexojeni formularin plotesisht dhe plotesojeni ate ne menyre te kujdesshme.

Udhezimet per plotesimin e formularit e gjeni si me poshte. Nese keni veshtiresi ne plotesimin e formularit keni te drejte te kerkoni asistencë legale ose ti drejtoheni gjykates. Ne rast se hapesira e formularit nuk eshte e mjaftueshme atehere mund ti jepni te dhenat ne nje flete shtese. Ju lutem te jepni informacione indikuese ne piken perkatese per fleten shtese.

E rendesishme:

Gjykata mund t'u kerkoje, qe dokumentat qe mungojne t'i paraqisni me vone nen deklaraten e betimit mbi te dhenat tuaja. Nese dokumentat e kerkuara nuk i paraqisni, kjo gje mund te coj qe kerkesa per miratim te ndihmes se shpenzimeve procesuale te hidhet poshte.

Nese jepni te dhena te paplota dhe te pasakta ,mund te coj qe ndihma e miratuar per shpenzimet procesuale t'ju hiqet dhe te paguani kostot e akumuluar .Nje gje e tille ju kercenon edhe nese ju gjate procesit gjyqesor dhe brenda nje afati kohor prej 4 vitesh qe prej vendimit te formes se prere ose te perfundimit per arsye te tjera te procesit, nuk i paraqisni gjykates permiresimet tuaja thelbesore te gjendjes ekonomike ose ne rast se keni ndryshim te adreses tuaj dhe kete ne menyre te menjehershme dhe pa jua kerkuar gjykata. Nese jepni ne menyre te ndergjegjshme te dhena te pasakta dhe te paplota mund te ndiqet si veper penale.

Udhëzime per plotesim.

Ju lutemi, plotesojeni formularin **ne te gjitha pjeset ne menyre te plote**. Nese pyetjet **kane pergjigje negative**, vini kryq ne kutine perkatese. Ju lutem bashkangjisni **dokumentat e nevojshme ne kopje** sipas radhes ,numerojini ato,dhe shkruani numrin perkates ne secilen kuti.

A. Ju lutem shenoni punesimin nga i cili merrni te ardhurat (pjesa E e formularit)

B. Nese keni siguracion per asistencë legale atehere duhet ti drejtoheni siguracionit.Ju lutem te bashkangjisni nje kopje te siguracionit. Nese siguracioni ju ka refuzuar marrjen persiper te shpenzimeve atehere bashkangjisni dhe nje kopje te saj.Ne qofte se jeni anetar i nje organizate e cila i mbron anetaret e saj nga diskutimet ligjore dhe mbrojtja e se drejtes duhet ti drejtoheni qe me pare kesaj organizate.Pranimi per ndihmen e shpenzimeve procesuale merret ne konsiderate nese Organizata ju ka refuzuar perballe dhenies nga mbrojtja ligjore.Nese do e plotesoni formularin pas aprovimit te ndihmes se shpenzimeve procesuale si qellim verifikimin e te dhenave personale dhe ekonomike,atehere nuk eshte e nevojshme per te dhena te tjera.

C. Detyrime per mirembajtje ligjore qendrojne ne parim midis te afermve ne linje te drejte (per prindritkundrejt femijeve te tyre dhe anasjelltas),midis bashkeshorteve, midis bashkejetuesve dhe bashkejetueseve te rregjistruara, midis nenave jo te martuara dhe babait te femijes mbas lindjes se nje femije. E drejta per mirembajtje lejon qe,

- personi qe ka te drejten e mirembajtjes eshte i paafte te mirembaj veten dhe
- personi pergjegjes per mirembajtjen qe merr ne konsiderate detyrimet e tjera te tij eshte ne gjendje ekonomike te kryeje/te japi mirembajtje.

Edhe femijet e moshes madhore kane si rregull te drejten e mirembajtjes ligjore kunder prinderve persa kohe qe ata ndodhen ne shkolle, kualifikim profesional ose jane me studime.Gjykates i nevojiten te dhenat shtese mbi marredheniet personale dhe ekonomike te personave me mirembajtje te detyrueshme.Edhe per (ata qe jetojne te ndare) bashkeshorte/bashkeshortet dhe partneri apo partnerja e jetes e rregjistruar mund te japin te dhenat ne pjesen E deri J te formularit.Ne raste te tjera ju lutem perdorni nje kopje tjeter te ketij formulari ku duhet plotesuar pjesa A dhe D deri te J. Ne rast se personi qe ka detyrim mirembajtjeje e refuzon bashkepunimin ju lutem jepni ne formular arsyen e refuzimit si dhe gjithashtu per ato qe jeni ne dijeni ne lidhje me ndryshimet personale dhe ekonomike te personit.

D. Nese jepni pagese mirembajtjeje per **pjesetare te familjes**, kjo do te merret parasysht te aprovimi i ndihmes per shpenzime procesuale. Eshte ne interesin tuaj qe te na informoni per cilet persona ju jepni pagese per mirembajtje dhe eshte e njejta gje nese ju pagesen per mirembajtje ekskluzivisht e jepni permes pageses monetare ose nese personat kane vete te ardhura. Tek te ardhurat e veta qe ka nje person per te cilin ju jepni pagese mirembajtjeje bejne pjese edhe pagesat per mirembajtje te nje te treti, vecanerisht ata te pjeses tjeter prinderore per femijen e tyre te perbashket ose nje shperblim per kualifikim profesional per te cilin e merr femija qe ka te drejte mirembajtjeje. **Per te gjitha keto te dhena duhet te bashkengjisni kopjet e deshmive (si p.sh. titullin e mirembajtjes dhe paraqitjen e pagesave).**

E. **Te ardhurat** nga nje **pune jo e pavaruar** jane vecanerisht rroga ose bustapaga. Duhet te jepni te ardhurat bruto te muajit te kaluar para se te benit kerkesen. Bonusin e krishtlindjeve ose te pushimeve apo dhe te ardhura te tjera te vetme ose te ardhura jo te rregullta duhet ti jepni vec e vec ne piken “andere Einnahmen “ dmth tek “te ardhura te tjera”.Gjithashtu duhet jepni kopje edhe per:

- 1. Rrogen e vendit ku keni punuar per 12 vitet e fundit para se te benit kerkesen;**

2. Nëse e keni marr **pergjigjen e fundit të zyrës së financës në lidhje me taksat mbi të ardhurat**. Në të kundërt **certifikatën elektronike të tatimit mbi të ardhurat, ku janë të paraqitura të ardhurat bruto dhe neto të vitit të kaluar**.

Te ardhurat nga **nje punë e pavarur, nga nje aktivitet produktiv ose agrokulturor apo ekonomie pyjore** duhet të jepet me një sasi aktuale mujore. E njëjta gjë vlen edhe për zbritjet e shpenzimeve të firmës në pikën F të formularit. Shumat mujore paraqitini në një fletë tjetër sipas një pasqyre financiare të ndermjetme si dhe fitimin që keni marr. Luhatjet sezonale ose të tjera në fitimin operativ duhet të merren parasysh përmes mbingarkesës ose reduktimit të arsyeshem. Në formular duhet të vendosni shumën të ardhurave mujore si dhe shpenzimet operative të cilat keni përlogaritur.

Nëse gjykata ju kërkon, atëherë duhet të paraqisni edhe të ardhurat e firmës me tatimin e regjistruar mbi vlerën e shtuar perkatese si dhe shpenzimet e firmës dhe faturat perkatese në kopje. **Gjithashtu duhet të paraqitet edhe pergjigja fundit, kopja, e taksave mbi të ardhurat nga zyra e financës**.

Në qoftë se merrni të ardhura nga **dheniet me qira** apo nga **pasuria kapitale** (p.sh. interesa kursimesh, dividende) atëherë paraqisni 1/12 të të ardhurave të pritshme vjetore.

Nëse merrni **pagesa për mirembajtje** për vetë dhe për fëmijet duhet të shënoni vetëm shumën e mirembajtjes që është vendosur për ju. Shumat e vendosura për fëmijet tuaj duhet të vendosni në kolonën e parafundit të pikës D në formular. Pyetja në lidhje me mirembajtjen mund të miratohet nëse shërbimet tuaja nuk do të koordinohen si pension mirembajtjeje por si **shërbim natyrorë** (p.sh. apartament të lire, furnizimi me ushqim, furnizime të tjera në shtëpinë e prindërve, shërbimet e partnerit ose partneres e një bashkejtesë të ngjashme me martesën). Vlera e parashikuar e këtyre shërbimeve plotësohet në pjesën E të formularit.

Në lidhje me të ardhurat që vijnë nga pensioni, përfitimet e papunesisë dhe përfitimet e papunesisë II, subvencionit për semundje, leket prinderore, shpërblim për kualifikim profesional ose shërbimet e tjera sociale duhet të vini dhe **kopjen e pergjigjes së fundit të miratimit të këtyre shërbimeve si dhe dokumentat që vijnë si rezultat i këtyre shërbimeve**.

Deklaroni me vlerën monetare të gjitha të tjerat, **të ardhurat** e të cilave nuk është përfshirë në rreshtat e mesipër, edhe shërbimet në natyrë (p.sh. shpërblimi në natyrë, mbajtje falas dhe pagesa të tjera në natyrë; banim falas vetëm nëse koston e banesës jepen poshtë pjesës H të formularit).

F. Si **zbritje taksash** mund të jenë keto të vlefshme:

1. taksat që hiqen nga të ardhurat tuaja (taksa e kishës, taksa e tregtisë, por jo tatimin mbi vlerën e shtuar) dhe kontribut solidarizmi;
2. Kontributet e detyrueshme për **sigurimet shoqërore** (psh siguracioni i pensionit, i shëndetit, i papunesisë dhe perkujdesit);
3. Kontributet për **siguracionet publike ose private ose ente të ngjashme** deri në masën që janë të pershkruara nga ligji. Nëse siguri nuk kërkohet nga ligji, mund të hiqen kontributet deri në shumën e cila është e pershtatshme në varesi të llojit dhe permasave të sigurimit. Ju lutemi, të shpjegoni llojin dhe permasat e sigurimit në një fletë tjetër nëse keto janë të paqarta

ne kopjet e dokumentave te bashkangjitura (p.sh. police siguracioni, fatura e pageses);

4. **Kostot e udhetimeve dhe e reklamave** te tjera, domethene perdorimet e nevojshme per blerje, sigurimin dhe marrjen e te ardhurave (p.sh. veshjet e punes, kontributi i sindikates). Ne qofte se kostot e udhetimit per ne pune i beni te vlefshme, atehere duhet te jepni largesine me kilometra. Nese perdorni makine, duhet te jepni arsyen pse nuk perdorni mjetet publike. Nga te ardhurat qe vijne nga puna e pavaruar duhet te specifikoni ketu dhe shpenzimet e firmes.

Kostot e pergjithshme te jeteses (p.sh. ushqimi, veshjet, telefoni ose korenti, per sa kohe nuk eshte e nevojshme ngrohja) gjykata i konsideron ne formen e kontributeve te pataksueshme.

- G. Ketu duhet te deklarohen te gjitha **kontot bankare, pronat, makinat, kontributet kesh, siguracionet per jeten, siguracionet private per pensionin dhe pasuri te tjera** (te perdorura edhe jashte shtetit) te cilat ju perkasin vetem ose bashke me bashkeshortin ose bashkeshorten, partnerin ose partneren e jetes te regjistruar. Nese ka nje ose me shume persona qe jane pjese e prones ju lutem te shenoni pjesen qe ju perket juve bashkeshortit/partnerit te jetes te regjistruar, ose te bashkeshortes/partneres se jetes te regjistruar. Dokumentat e pershtatshme per kete duhen me kopje. Gjykata mund t'ju kerkoje per motive justifikimi dokumenta te tjera (p.sh. pasqyrat bankare per nje periudhe kohore paraardhese te gjate).

Ndihma per shpenzimet procesuale mund te miratohet, nese pasuria eshte ekzistente, por kjo shërben per sigurimin e pershtatshem te mjeteve te jeteses ose te sherbeje per nje mase paraprake te pershtatshme. Si pasuri te tilla vlejne p.sh.:

- perdoruesi i nje shtepie ne pronesi te tij,
- kapitali i cili i sherben pensionit shtese sipas ligjit te taksas mbi te ardhurat, akumulimi i te cilave promovohet nga shteti („Riester-Rente“),
- nje automjet i pershtatshem nese nevojitet per kualifikim ose per ushtrim profesional
- kontribute te vogla monetare (prill 2017, kontribute deri ne 5000 € per palen qe eshte ne nevoje plus 500 € per cdo person qe do te mbahet kryesisht nga pala).

Keto vlera te pasurise duhet te deklaroni me patjeter!

Orendite shtepiake, veshje dhe objekte, te cilat do te nevojiten per kualifikimin ose per ushtrimin profesional duhet ti deklaroni nese e kaloni limitin e zakonshem ose nese behet fjale per objekte me vlere te larte.

Per pasurine truell me ndertime jepni siperfaqen e pergjithshme perkatese e cila do te perdoret per qellime banimi, jo vetem siperfaqet e perdorura tuaja dhe te pjesetareve tuaj (pa pjesen D).

Per **pasurite e patundshme** duhet te deklarohet vlera aktuale, te shoqeria e kreditit per pasuri te patundshme, llogarite bankare, llogarite rrjedhese, llogarite e kursimeve si bilancin e llogarise rrjedhese. Te letrat me vlere numrin e letrave, numrin e identifikimit te letrave me vlere si dhe vlera e tanishme ne burse kurse te sigurimi i jetes vlera e dorezimit. Dokumentat perkatese si psh deshmite nga banka ose siguracionet duhen bashkangjitur me kopje.

Nen zerin "**asetet e tjera**" futen pervec se kreditet kundrejt te tjereve, edhe kerkesa per ndarjen e pasurise ne procesin e divorcit.

Ne qofte se perdorimi ose shfrytezimi i nje objekti te pasurise nje vlere te vecante per ju dhe

familjen tuaj ju lutem shpjegoni kete ne nje flete tjeter.

- H. Nese **kostot e baneses** do te behen te vlefshme jepni siperfaqen e baneses, numrin e dhomave dhe numrin e personave qe do banojne ne te.

Kostot shtese te qirase jane (me perjashtim te **koshtos se ngrohjes**) **kostot e firmes** perfshire ketu (takse toke, furnizimi me uje, kanalizimet, pastrimi rrugor, marrja e plerave, fshirja e oxhakut, ashensori, korrenti i pergjithshem, pastrimi i shtepise, antena e perbashket e televizorit etj). Nuk perfshihet gazi ose kostoja e korrentit si dhe telefoni dhe GEZ (taksa e radio-televizionit).

Ne ngarkesen nga fondet e huaja te **pronesia e shpise** bejne pjese kesti i kredise i cili eshte perfshire per ndertimin, blerjen ose ruajtjen. **Kostot shtese** jane ketu me perjashtim te kostove tespecifikuara ngrohjes ,kostot e firmes.

Ne qofte se banesen do e perdori dhe dikush tjeter qe ka te drejte mirembajtjeje (pa pjesen D), ju lutem te shkruani vetem pjesen qe ju takon .**Dokumentat e nevojshme si p.sh. kontraten e shtepise, certifikaten e kredise si dhe faturen e kostove shtese duhet ti bashkangjisni ne kopje.**

- I. Duhet te bashkangjisni dokumentat e nevojshme per pagesat mujore si dhe shumen e pjeses tjeter te borxhit nese keni marr obligimin e pageses per te blere nje aset pasurie qe eshte dhene poshte pjeses G
- J. Nese beni te vlefshme nje **ngarkese te vecante**, jepni ju lutem kontributin mujor, ose kontributet mujore ne menyre proporcionale te cilat duhen hequr nga te ardhurat tuaja ose te bashkeshortit/partnerit te jetes te regjistruar ose te bashkeshortes/partneres te jetes te regjistruar. Pervec dokumentave bashkangjisni edhe nje shpjegim ne nje leter tjeter. Nese bashkeshorti apo partneri i jetes ka patur nje ngarkese mirembajtjeje nga nje martesë e hershme ose lidhje e meparshme mund ta deklaroni ne formular.
- Nese ndodheni ne nje shtate te vecante te jetesdhe prandaj kushtet per dhenien e nevojshmerise shtese sipas paragrafit §21 SGB II ose §30 SBG XII te jete i pranishem.

Ju permend keto shembuj:

- nenat e ardhshme mbas javes se 12 te shtatzanise
- personat te cilet jetojne me nje ose disa femije minoren dhe kujdesen per ta dhe edukimin e tyre
- personat me aftesi te kufizuar ,te cileve u jepen sherbime te caktuara sipas SGB XII
- personave te cileve nga ana mjekesore u kerkohet nje ushqim i kushtueshem

- K Shpjegimi duhet te firmoset nga vete pala ne rreshtat e fundit edhe nen asistencen e avokatitTe asistenca ligjore duhet te firmosi perfaqesuesi ligjor.